



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 22 korrik 2024

Nr. Ref.:RK 2474/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI193/23**

Parashtrues

**Vllaznim Hamdija**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të  
Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 135/2023, të 10 majit 2023**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Vllaznim Hamdija (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), nga Komuna e Gjilanit i përfaqësuar nga Artan Qerkini, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML. nr. 135/2023] të 10 majit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 731/2022] e 26 janarit 2023 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin mëtejshëm: Gjykata e Apelit) si dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 141/2022] e 22 nëntorit 2022 të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 8 qershor 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 18 shtator 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 26 shtator 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [nr. Gjr. KI193/23] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe përmes vendimit [nr. KSH. KI193/23] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi – Peci dhe Enver Peci.
8. Më 25 shtator 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.
9. Më 25 shtator 2023, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Gjilan për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të dorëzojë fletëkthesën se kur e ka pranuar parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar.
10. Më 6 tetor 2023, Gjykata pranoi fletëkthesën e dorëzuar nga Gjykata Themelore.
11. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

12. Më 26 qershor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

13. Më 5 mars 2020, Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, pranë Gjykatës Themelore në Gjilan ka paraqitur aktakuzën [PP. I. Nr. 239/2019], ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të kryerjes së veprave penale vrasje e rëndë sipas nenit 173, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedimi i paautorizuar të armëve sipas nenit 366, paragrafi 1; si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafët 1 dhe 3 të Kodit [NR. 06/L-074] Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kodi Penal).
14. Më 13 tetor 2021, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktgjykimit [PKR. nr. 34/2020] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprat penale të vrasjes së rëndë sipas nenit 173, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1, si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafi 1 dhe 3, të Kodit Penal. Gjykata Themelore vendosi një dënim unik burgu për të gjitha këto vepra për një kohëzgjatje prej 25 vitesh burgim, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim. Po ashtu, u konfiskuan armët dhe municioni në përputhje me dispozitat e paragrafit të dytë dhe të tretë të Aktgjykimit.
15. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta aprovojë ankesën si të bazuar, të anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
16. Ndërsa, përfaqësuesja e palës së dëmtuar, i propozoi Gjykatës së Apelit, ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar për të shqiptuar një dënim maksimal për parashtruesin e kërkesës në lidhje me sanksionin penal.
17. Prokuroria e Apelit ka propozuar që të aprovohet ankesa e përfaqësueses së palës së dëmtuar, duke u bazuar në propozimin e saj për ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar dhe për të shqiptuar një dënim maksimal për parashtruesin e kërkesës. Ndërkaq, ankesa e mbrojtëses së parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
18. Më 12 janar 2022, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [PAKR. nr. 498/2021] kishte aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimit për dënimin e shqiptuar dhe ndryshoi Aktgjykimin [PKR. nr. 341/2020] e Gjykatës Themelore të 13 janarit 2021, ashtu që ka bërë ricilësimin juridik të veprës penale. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor për veprën penale të vrasjes nga neni 172 i Kodit Penal. Gjykata vendosi një dënim unik me burgim për të gjitha veprat penale për një kohëzgjatje prej 23 vitesh burgim, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim. Gjykata e Apelit gjithashtu refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së dëmtuar, kurse pjesa tjetër e aktgjykimit ka mbetur e pandryshuar.
19. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është nxjerrë në shkelje të dispozitave të procedurës penale, siç parashihet në nenin 384, paragrafin 1.2 të Kodit [NR. 08/L-032] të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: Kodi i Procedurës Penale) pasi në përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës

Themelore, veçanërisht si kryetar i trupit gjykues, mori pjesë gjyqtari I.Th., i cili gjithashtu mori pjesë edhe në cilësinë e gjyqtarit të procedurës paraprake gjatë procedurës hetimore, duke dhënë urdhër verbal për bastisje të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të pronës së të dënuarit. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme që të anulohet aktgjykimet e lartcekura dhe të kthejë lëndën në rigjykim.

20. Më 18 korrik 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. 239/2022] të 18 korrikut 2022 vendosi si në vijim:

*“Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit V.H., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.34/2020 të datës 13.09.2022 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.498/2021 të datës 12.01.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim”.*

21. Gjykata Supreme përmes të njëjtit Aktgjykim ka arsyetuar se përbërja e trupit gjykues në Gjykatën Themelore në procesin penal të parashtruesit të kërkesës ka qenë e paligjshme, duke shkelur nenin 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Kodit të Procedurës Penale, sepse në trupin gjykues të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht në rolin e kryetarit të trupit gjykues, ka marrë pjesë gjyqtari I.TH., i cili duhej të përjashtohet pasi që ka qenë pjesë e një çështje penale në cilësinë e gjyqtarit të procedurës paraprake gjatë hetimit, duke dhënë urdhër verbal për bastisje të shtëpisë dhe objekteve të pronës së parashtruesit të kërkesës.

### **Procedura e rigjykimit**

22. Më 22 nëntor 2022, Gjykata Themelore në procedurën e rigjykimit nxjerr Aktgjykimin [PKr. nr. 141/20222] përmes të cilit shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të vrasjes sipas nenit 172; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1, si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafët 1 dhe 3, të Kodit Penal. Me këtë rast, Gjykata i ka shqiptuar dënime me burgim në total prej 20 vitesh, duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e armëve dhe fishekëve të gjetur në pronësi të të akuzuarit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu është obliguar të paguajë paushallin gjyqësor, shpenzimet e ekspertizës, shpërblimin për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si dhe shpenzimet e procedurës, në afat prej 10 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Ndërsa, i dëmtuari B. S., është udhëzuar në kontekstin e rregullt civilo-juridik për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.
23. Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, Prokuroria Themelore në Gjilan, kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit për dënimin, ashtu që parashtruesit të kërkesës t' i shqiptohet një dënim unik me burgim në kohëzgjatje më të gjatë.
24. Gjithashtu, përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.
25. Ndërsa, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit lidhur me

sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale të kthehet në të njëjtën gjykatë për rigjykim dhe vendosje. Po ashtu, ai propozon që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, në mënyrë që të aplikohen dispozitat për zbutjen e dënimit, nga neni 71 dhe 72 i Kodit Penal, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, për të shqiptuar një dënim që të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit.

26. Më 26 janar 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 731/2022] vendosi si në vijim:

*I. Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan, përfaqësueses së autorizuar të palës së dëmtuar, av. V.K., si dhe mbrojtëses së të akuzuarit V.H., avokatja Erëmira Halimi Hamidi, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR nr. 141/2022, të datës 22.11.2022, vërtetohet.*

*II. Hedhet si e pa lejuar, ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, av. V.K., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR nr. 141/2022, të datës 22.11.2022, në lidhje me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

27. Gjykata e Apelit, nëpërmjet të të njëjtit aktgjykim, arsyetoi se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk përfshihet në shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal me arsyetimin se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, duke përfshirë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke u bazuar në provat e tjera. Prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata Themelore, me rastin e nxjerrjes së vendimit për dënimin, caktimin dhe llojin e tij, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat në përputhje me nenin 69 dhe 70 të Kodi Penal, duke përfshirë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.
28. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nenin 370, 384 dhe 385 të Kodit të Procedurës Penale.
29. Më 4 prill 2023, Kryeprokurori i Shtetit përmes shkresës [KMLP. II. nr. 84/2023] i ka propozuar Gjykatës Supreme që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
30. Më 10 maj 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 135/2023] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që në të janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, duke përfshirë këtu edhe arsyet në lidhje me rrethanat rënduese.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Pml. nr. 135/2023] i 10 majit 2023 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në rastet Penale] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNj-së.

Parashtruesi i kërkesës, specifikisht pretendon shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor dhe shkelje të parimit të legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale.

***Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së***

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se *“disa nga pretendimet dhe argumentet kryesore të parashtruesit nuk janë adresuar nga asnjë shkallë gjyqësore, që nga Gjykata Themelore e deri tek Gjykata Supreme”*.
33. Lidhur me pretendimin për mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se *“Në vijë të përgjithshme, parashtruesi, përmes mbrojtjes së tij, përgjatë tërë procesit gjyqësor kundër ka ngritur disa pretendime dhe argumente kryesore, duke filluar nga: a. mosvërtetimi i fakteve vendimtare nga ana e gjykatave; b. mostrajtimi i pretendimeve se parashtruesi kishte kryer veprën penale nën afekt; c. moszbatimi i drejtë i Udhëzuesit për Politika Ndëshkimore; d. mosmarrja shqyrtimi nga ana e gjykatave, në mënyrë të drejtë dhe të duhur, i rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen caktimin e dënimit”*.
34. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se *“pretendimet kryesore të ngritura nga parashtruesi në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ishin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së dytë nuk paraqesin arsytet lidhur me faktet vendimtare dhe se këto arsye janë të paqarta dhe kundërthënëse”*.
35. Përkitazi me pretendimin për mos arsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se *“Aktgjykimi [PML. nr. 135/2023] të 10.05.2023 karakterizohet nga mungesa e arsytimit, respektivisht se Gjykata Supreme ka dhënë arsyetim të pamjaftueshëm dhe jo-adekuat, duke cituar arsytimet e gjykatave të shkallës më të ulët apo duke i përsëritur ato, për pasojë, edhe pse rasti ka marrë epilog gjyqësor në gjykatat e rregullta, kanë mbetur pa u ndriçuar tërësisht faktet e rastit; nuk është shqyrtuar asnjëherë çështja e afektit nën të cilin është kryer vepra; nuk është qartësuar a e kanë zbatuar gjykatat në mënyrë të duhur Udhëzuesin për Matje të Dënimeve; nuk është sqaruar se a janë marrë parasysh nga gjykatat, sa dhe si duhet, rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*.
36. Në lidhje me arsytimin e Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim:

***“Arsytimi i gjykatës së shkallës së parë është i paqartë kur trajtohen rrethanat rënduese si: shkalla e lartë e dashjes, drejtimi i revoles kah djali i të ndjerit, kryerja e vrasjes në praninë e të ndjerit, shkaktimi i dëmit të pariparueshëm. Nuk mund të merret si rrethanë rënduese fakti se i akuzuari (parashtruesi) ka qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës dhe se atij i janë gjetur nëntëmbëdhjetë fishekë të armës zyrtare. Në lidhje me këtë, mbrojtja e parashtruesit argumentoi se sipas legjislacionit penal, në aktgjykim dënues duhet të arsyetohet e jo vetëm të theksohen, si rrethanat lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese; gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare, për llojin dhe lartësinë e dënimit dhe pse pjesa kryesore e rrethanave që janë konsideruar si rënduese, mund të konsiderohen të tilla; gjykata e shkallës së parë si rrethanë rënduese merr faktin se i akuzuari me rastin e kryerjes së veprës penale të vrasjes ka manifestuar një shkallë të lartë të dashjes. Kjo rrethanë nuk është arsyetuar, sepse gjykata e shkallës së parë ka treguar se çka konsiston shkalla e***

lartë e dashjes, kur dihet se i akuzuari (parashtruesi) dhe viktimas që janë njohur mes veti; konflikti është shkaktuar nga një aksident komunikacioni, me ç' rast pala e dëmtuar i ka kontribuar fjalosjeve të ndërsjellë; kjo është e një rëndësie qenësore, sepse po të mos ekzistonte dashja i njëjti do të shpallej fajtor për vrasje nga pakujdesia. Si rrethanë rënduese gjykata e shkallës së parë ka marrë edhe faktin se i akuzuari ia kishte drejtuar revolen djalit të të ndjerit e që kjo rrethanë nuk është vërtetuar; si rrethanë rënduese është marrë se vrasja ishte kryer në prani të të ndjerit që kishte shkaktuar shqetësim të madh, rrethanë kjo e paarsyetuar ngase çdo vrasje shqetësim dhe se është shpërfillur fakti se edhe djali i të ndjerit i ka kontribuar zhvillimit të konfliktit verbal, para kryerjes së vrasjes dhe se në momentin kritik fare nuk ka qenë pranë të ndjerit; si rrethanë rënduese është marrë fakti se i akuzuari (parashtruesi), në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës dhe se veprën e ka kryer me armë zyrtare. Ky vlerësim është i gabueshëm, sepse nuk e merr për bazë faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale i akuzuari (parashtruesi) nuk ka qenë në detyrë dhe rrethanat se vepra penale është kryer pas aksidentit të trafikut të shkaktuar nga i ndjeri dhe konflikteve verbale, sulmit dhe kanosjeve të shkaktuara nga ana e të ndjerit dhe birit të tij; si rrethanë tjetër rënduese është marrë dëmi i pariparueshëm - vdekja e të ndjerit - e cila vdekje nuk mund të merret si rrethanë rënduese, ngase është element konstitutiv i veprës penale”.

37. Në lidhje me arsyetimin e Gjykatës së Apelit, në kontekst të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, parashtruesi i kërkesës pohon:

*“Përkitazi me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë parashtruesi argumentoi se Gjykata e Apelit, jo vetëm që nuk ka trajtuar në mënyrë të plotë këto pretendime dhe argumente thelbësore, të paraqitura më sipër, por ka dhënë aktgjykim i cili përfshihet me shkelje edhe më drastike sesa aktgjykimi i shkallës së parë. Parashtruesi (përkatësisht mbrojtja) ka argumentuar qartë se Gjykata e Apelit nuk ka adresuar faktet dhe rrethana thelbësore, të cekura më sipër e të cilat po të shqyrtoheshin në mënyrë të plotë dhe të drejtë do të kishin efekt në lartësinë e dënimit të shqiptuar. Në mënyrë të veçantë, parashtruesi ka pretenduar se po të merreshin për bazë në mënyrë të duhur të gjitha rrethanat lehtësuese, vendimi mbi dënimin do të ishte shumë më i favorshëm për të”.*

38. Në mbështetje të pretendimeve për dështimin e Gjykatës Supreme për të përmbushur standardin e vendimit të arsyetuar, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Në Aktgjykimin Pml.nr. 135/2023 me të cilin refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë (aktgjykimi i kontestuar), Gjykata Supreme adresoi me argumente të përgjithshme, sipërfaqësore dhe gjuhë shabllonike vetëm disa nga pretendimet specifike të ngritura nga parashtruesi. Këtë e bëri duke i cituar dhe aprovuar gjetjet dhe interpretimet e gjykatave të shkallës më të ulët, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të mënyrës sesi gjykatat e shkallës më të ulët kanë bërë konstatimet e tyre”.*
39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj tij kanë trajtuar si rrethanë rënduese faktin e të qënurit pjesëtar i Policisë së Kosovës, në kundërshtim me praktikën gjyqësore të vet Gjykatës Supreme, e cila një rast të ngjashëm këtë rrethanë e kishte trajtuar ndryshe, duke evidentuar përfundimisht mungesën e konsistencës në vendimmarrjen e Gjykatës Supreme.
40. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson: *“për pasojë, edhe pse rasti ka marrë epilog gjyqësor në gjykatat e rregullta, kanë mbetur pa u ndriçuar tërësisht faktet e rastit; nuk është shqyrtuar asnjëherë çështja e afektit nën të cilin është kryer vepra; nuk është qartësuar a e kanë zbatuar gjykatat në mënyrë të duhur Udhëzuesin për*

*Matje të Dënimeve; nuk është sqaruar se a janë marrë parasysht nga gjykatat, sa dhe si duhet, rrethanat lehtësuese dhe rënduese”.*

41. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se “*Ndonëse standardi i vendimit të arsyetuar gjyqësor i lejon gjykatat e shkallës më të ulët që të pranojnë arsyetimet e gjykatave të shkallës më të lartë, kjo nuk nënkupton që gjykatat e shkallës më të lartë të mos shqyrtojnë në mënyrë të pavarur faktet, argumentet dhe pretendimet kryesore të ngritura nga palët në procedurë. Po të ishte kështu, atëherë do ishte jologjike dhe tërësisht e padobishme që palët në procedurë t’i drejtohen Gjykatës Supreme. Detyrimi i Gjykatës Supreme për të shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe të pavarur argumentet dhe pretendimet e palëve - pavarësisht nga gjetjet dhe interpretimet që kanë bërë gjykatat e shkallës më të ulët - buron nga neni 31 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së [...] Këtë detyrim nuk e ka përmbushur Gjykata Supreme në këtë rast dhe kjo është e dukshme nëse analizohen pretendimet kryesore që janë ngritur nga parashtruesi në procedurën penale ndaj tij, duke përfshirë edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe arsyetimet e dhëna nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e shkallës më të ulët”.*
42. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se Aktgjykimi i kontestuar është në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GjEDNJ).
43. Përgjatë pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës ka shtjelluar parimet themelore të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor, siç është e garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe në mbështetje të këtyre argumenteve, parashtruesi i kërkesës i është referuar edhe praktikës gjyqësore të (i) Gjykatës në rastet KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 5 dhjetorit 2012; KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2015; KI138/15, parashtrues *"Sharr Beteiligungs GmbH" SH.P.K.*, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017; KI138/15, parashtrues *"Sharr Beteiligungs GmbH" SH.P.K.*, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017; KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 2 majit 2017, KI87/18, parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019; KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli"*, Aktgjykim i 29 marsit 2021; si dhe (ii) GjEDNJ-së në rastet *Hiro Balani kundër Spanjës* (Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994); *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, (Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998); *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Tatishvilli kundër Rusisë* (Aktgjykim i 22 shkurtit 2007); *Morerira Ferreira kundër Portugalisë* (Aktgjykim i 5 korrikut 2008).

***Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 33 (3) të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së.***

44. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se garancionet e mishëruar nga neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] në lidhje me nenin 7 [Nuk ka dënim pa ligj] të KEDNJ-së, janë shkelur nga ana e gjykatave të rregullta me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj tij me arsyetimin se dënimi ndaj tij është shqiptuar pa u verifikuar faktet vendimtare të rastit dhe pa trajtuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme, duke vënë në dyshim arsyetimet e gjykatave të rregullta lidhur me konstatimin e “*shkallës së lartë të dashjes*” së tij gjatë kryerjes së veprës penale si dhe moszbatimin e Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore gjatë shqiptimit të dënimit. Në lidhje me këtë, parashtruesi pohon se nëse rrethanat do të trajtoheshin në mënyrë të drejtë dhe do të zbatoheshin politikën për ndëshkimin nga gjykatat e rregullta, dënimi do të ishte më i lehtë dhe në përputhje/proporcion me natyrën e veprës dhe rrethanat e kryerjes së saj.



45. Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimeve për shkelje të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, thekson:

*“Neni 33 i Kushtetutës, në ndërlidhje me Nenin 7 të KEDNJ-së (Nuk ka Dënim pa Ligj) paraqesin një prej shtyllave të sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së qytetarëve nga arbitrariteti shtetëror. Referuar juridiksionit të GjEDNJ-së, garancioni që ofron Neni 7 i KEDNJ-së, në raste të caktuara, është ndërlidhur edhe me Neni 3 i KEDNJ-së (Ndalimi i torturës)”.*

*Siç u theksua më lart, parimi i ligjshmërisë/legalitetit qëndron në themel të neneve 33 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së dhe ka zbatueshmëri shumë rigorozë në të drejtën penale. Si i tillë, parimi i legalitetit i jep legjitimitet normave penale në një shoqëri demokratike, duke përcaktuar disa garancione themelore që mbrojnë individin nga arbitrariteti dhe pasiguria juridiko-penale. Në rrafshin penal, parimi i legalitetit kërkon, inter alia, që: vetëm ligji i shkruar të përcaktoj veprën penale dhe sanksionin penal (nullum crimen, nulla poena sine lege); ndalohet veprimi retroaktiv i ligjeve me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës; ndalohet inkrimini penale në bazë të analogjisë me ligje të tjera (nullum crimen sine lege stricta); caktimi i dënimit të të akuzuarve të shpallur fajtor për vepra penale duhet të bëhet sipas ligjit (duke përfshirë edhe aktet nënligjorë përkatëse).*

*Në praktikën e saj të bollshme, GjEDNJ ka mbajtur qëndrim se, ndonëse parimisht çështjet e lartësisë së dënimit nuk hyjnë brenda fushëveprimit të KEDNJ-së, një dënim dukshëm shpërpjesëtimorë (joproporcional) mund të cilësohet si keqtrajtim që është në kundërshtim me Nenin 3 të KEDNJ-së, në momentin e shqiptimit të tij. Siç ka sqaruar GjEDNJ në rastet Ahmad dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (aktgjykimi i vitit 2012, paragrafi 237); Harkins dhe Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar (aktgjykimi i vitit 2012, paragrafi 133), testi i "dënim i dukshëm joproporcional," në kuptim të Nenit 3 të KEDNJ-së, zbatohet në raste të rralla. Kjo duke qenë se garancionet që ofron KEDNJ nga shqiptimi i dënimeve joligjore dhe arbitrarë janë të mishëruara në Nenin 7 të KEDNJ-së”.*

46. Parashtruesi i kërkesës në vazhdim pohon: *“përkitazi me ashpërsinë e dënimit, si praktikë e përgjithshme, GjEDNJ është kufizuar në shqyrtimin se a u shqiptohen personave të shpallur fajtorë dënime më të rënda sesa ato që kanë qenë të parapara në momentin e kryerjes së veprës penale. Rrjedhimisht, çështja se a është shqiptuar dënimi i duhur dhe në lartësinë e duhur (nëse është dënim me burgim), sipas praktikës së GjEDNJ-së, parimisht nuk bie në fushëveprimin e Nenit 7 të KEDNJ-së (shih rastin e GjEDNJ-së, Hummatov kundër Azerbejxhanit; Hakkar kundër Frances; Vinter dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar)”.*
47. Përkitazi me dënimin e shqiptuar nga gjykatat e rregullta, parashtruesi i kërkesës nënvizon se *“GjEDNJ ka përcaktuar në mënyrë të qartë se "parimi i ligjshmërisë" nuk lejon që një të akuzuari t'i shqiptohet dënim më i rëndë sesa dënimi që përkon me veprën e kryer që nënkupton jo vetëm llojin e veprës por edhe rrethanat e kryerjes së saj. Në këtë sfond, GjEDNJ ka gjetur shkelje të Nenit 7 të KEDNJ-së në rastet kur gjykatat e shteteve kanë gabuar në caktimin e lartësisë së dënimit, duke mos shqyrtuar si duhet rrethanat lehtësuese dhe rënduese”.*
48. Në kontekst të shkeljes së nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës argumenton se *“në aktgjykimin e saj në rastin Gabarri Moreno kundër Spanjës (Aktgjykimi i datës 22 korrik 2023), GjEDNJ gjeti shkelje të*

*Nenit 7 për shkak të mënyrës së caktimit të lartësisë së dënimit, përkatësisht dështimit të gjykatave për të marrë parasysh disa rrethana lehtësuese specifike. Gjykata arsyetoi, inter alia, se po të merreshin parasysh rrethanat lehtësuese, dënimi i të akuzuarit sipas legjislacionit penal të Spanjës do të ishte në mes të 6 vitesh dhe 1 dite dhe 8 vitesh. Ndërsa i akuzuari ishte dënuar me 8 vite e nja dite burgim”.*

49. Parashtruesi i kërkesës konkludon duke theksuar se “*në dritën e sqarimeve dhe elaborimeve të mësipërme dhe duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, është shumë e qartë se garancionet që derivojnë nga parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale janë shkelur me aktgjykimet dënuese ndaj parashtruesit të kësaj kërkesë, z. Vllaznim Hamdija. Kjo ngase, siç mund të vërehet qartë nga faktet dhe pretendimet e pasqyruara më sipër, parashtruesit të kërkesës i është caktuar dëmtimi pa u vërtetuar faktet vendimtare të rastit, nga të cilat derivojnë rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Këtë pretendim parashtruesi (përmes mbrojtjes së tij) e ka paraqitur në vazhdimësi dhe në mënyre të argumentuar përgjatë tërë procedurës gjyqësore, në të gjitha fazat”.*
50. Në lidhje me vendimmarrjen e gjykatave të rregullta përkitazi me lartësinë e dënimit, parashtruesi i kërkesës thekson: “*gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë bindëse konstatimin se parashtruesi me rastin e kryerjes së veprës penale ka manifestuar një shkallë të lartë të dashjes. Kjo rrethanë nuk është arsyetuar sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka treguar/arsyetuar se në çka konsiston shkalla e lartë e dashjes; nuk ka trajtuar asnjëherë rrethanat qenësore të rastit që çojnë në përfundimin se vepra mund të jetë kryer në afekt; nuk kanë dhënë përgjigje të elaboruar lidhur me pretendimin për moszbatimin e Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore”.*
51. Sipas parashtruesit të kërkesës, “*po të shqyrtoheshin në mënyrë të drejtë rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe po të aplikoheshin Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, parashtruesi i kërkesës do të mund të dënohej me dënim më të lehtë e që do të ishte në përputhje me peshën e veprës, rrethanat e kryerjes së saj, si dhe shkallën e fajësisë së parashtruesit”.*
52. Parashtruesi i kërkesës tutje pohon se “*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 135/2023, ka cenuar parimin e legalitetit dhe proporcionalitetit në Rastet Penale, për shkak të lëshimeve dhe gabimeve që janë bërë nga gjykatat me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit”.*
53. Përgjatë pretendimeve të tij, në mbështetje të këtyre argumenteve të lartcekura, parashtruesi i kërkesës i është referuar edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në rastet: *Hummatov kundër Azerbejxhanit* (Aktgjykimi i 29 nëntorit 2007); *Hakkar kundër Francës* (Vendimi i 7 prillit 2009); *Harkins dhe Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim i 17 janarit 2012); *Ahmad dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim i 10 prillit 2012); *Vinter dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim i 9 korrikut 2013); dhe *Gabbarri Moreno kundër Spanjës* (Aktgjykim i 22 korrikut 2023).
54. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesën e tij ta shpallë të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë që Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [Pml. nr. 35/2023] i 10 majit 2023 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 dhe 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe 7 të KEDNJ-së, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje.

## Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

### Kushtetuta e Republikës së Kosovës

#### Neni 31

##### [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

#### Neni 33

##### [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë veprë e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si veprë penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.
2. Dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.
3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.
4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

### Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

#### Neni 6

##### (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
- [...]

#### NENI 7

##### (Nuk ka dënim pa ligj)

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

## **KODI [06/L-074] PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

### **Neni 172 Vrasja**

*Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.*

### **Neni 366 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**

1. *Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

2. *Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.*

3. *Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.*

### **Neni 367 Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm**

1. *Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*

2. *Kushdo që përdorë armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.*

3. *Arma apo mjete i rrezikshëm i përdorur në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

55. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
56. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

57. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

### Neni 47 (Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

### Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

### Neni 49 (Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.*

58. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 135/23] e Gjykatës Supreme, të 10 majit 2023, dhe e ka parashtruar brenda afatit pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës i ka qartësuar të drejtat dhe liritë kushtetuese, që ai pretendon se i janë shkelur.



59. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 34 (2) parasheh:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*

60. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
61. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” shih rastet e GJEDNJ-së, [Kemache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituaniës](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
62. Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).

63. Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me aktakuzën [PP. I. nr. 239/2019], e paraqitur nga Prokuroria Themelore në Gjilan ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të kryerjes së veprave penale vrasje e rëndë sipas nenit 173, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedimi i paautorizuar të armëve sipas nenit 366, paragrafi 1; si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafi 1 dhe 3 të Kodit Penal.
64. Çështja e parashtruesit të kërkesës ishte shqyrtuar përmes gjashtë (6) vendimeve gjyqësore, duke u vendosur fillimisht nga Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit [PKR. nr. 34/2020] ku shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprat penale të vrasjes së rëndë sipas nenit 173, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1, si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafi 1 dhe 3, të Kodit Penal. Gjykata Themelore vendosi një dënim unik burgu për të gjitha këto vepra për një kohëzgjatje prej 25 vitesh burgim, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim. Po ashtu, u konfiskuan armët dhe municioni në përputhje me dispozitat e paragrafit të dytë dhe të tretë të Aktgjykimit. Pas ankimimit, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit [PAKR. nr. 498/2021], miratoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale dhe dënimin. Si pasojë, parashtruesi u shpall fajtor për veprën penale të vrasjes nga neni 172 i Kodit Penal, dhe u dënua me burg për 23 vjet, duke përfshirë kohën e paraburgimit. Ndërsa, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml. 239/2022] të 18 korrikut 2022 anuloi aktgjykimet e lartcekura dhe ktheu rastin në rigjykim në shkallë të parë me arsyetimin qendrorë se përbërja e trupit gjykues në Gjykatën Themelore ishte e paligjshme sipas nenit 384, paragrafi 1.2 të Kodit të Procedurës Penale.
65. Në rigjykim, Gjykata Themelore ka nxjerrë Aktgjykimin [PKr. nr. 141/20222] e 22 nëntorit 2022, ku shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për vrasje sipas nenit 172, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1, si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafët 1 dhe 3, të Kodit Penal. Më këtë rast, Gjykata Themelore i ka shqiptuar dënime me burgim në total prej 20 vitesh, duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e armëve dhe fishekëve të gjetur në pronësi të të akuzuarit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu është obliguar të paguajë paushallin gjyqësor, shpenzimet e ekspertizës, shpërblimin për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si dhe shpenzimet e procedurës, në afat prej 10 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm. Ndërsa, i dëmtuari B. S., është udhëzuar në kontekstin e rregullt civilo-juridik për realizimin e kërkesës pasurore-juridike. Ky vendim ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 731/2022] të 26 janarit 2023 dhe nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 135/2023] të 10 majit 2023, duke refuzuar kërkesën e parashtruesit me arsyetimin se Aktgjykimi [PKr. nr. 141/20222] i Gjykatës Themelore nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që në të janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, duke përfshirë këtu edhe arsyet në lidhje me rrethanat rënduese.
66. Konstatimet e lartcekura, parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës duke pretenduar shkelje të nenit 31 dhe 33 të Kushtetues në ndërlidhje me nenin 6 dhe 7 të KEDNj-së. Parashtruesi i kërkesës, specifikisht pretendon shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor dhe shkelje të parimit të legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale.
67. Gjykata, në vijim, do t'i trajtojë veç e veç secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mbi bazën e të cilës



Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

***Pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së***

68. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, duke theksuar, ndër të tjera dhe siç është sqaruar më lart, se Aktgjykimi i kontestuar në lidhje me aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Themelore kanë dështuar që të ofrojnë arsyetim të mjaftueshëm lidhur me vlerësimin e fakteve relevante të rastit që kanë çuar në vendimmarrjen konkrete nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë vlerësimin dhe aplikimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në disfavor të parashtruesit të kërkesës, duke rezultuar në një dënim të rëndë për parashtruesin, pa një analizë dhe arsyetim të mjaftueshëm të rrethanave juridike dhe faktike gjatë vendimmarrjes në rastin konkret.
69. Gjykata vëren se lidhur me këtë aspekt specifik, pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës është se para gjykatave të rregullta kishte ngritur pretendime të cilat nuk i ishin trajtuar dhe arsyetuar “*duke filluar nga: a. mosvërtetimi i fakteve vendimtare nga ana e gjykatave; b. mostrajtimi i pretendimit se parashtruesi kishte kryer veprën penale nën afekt; c. moszbatimi i drejtë i Udhëzuesit për Politika Ndëshkimore; d. mosmarrja shqyrtimi nga ana e gjykatave, në mënyrë të drejtë dhe të duhur, i rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen dhe caktimin e dënimit*”.
70. Gjykata përmes një vëzhgimi të përgjithshëm vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë dështuar të ofrojnë arsyetim me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese në rastin e tij, duke marrë parasysh faktet selektive dhe të pavërtetuara, siç është “*shkalla e lartë e dashjes*” me rastin e kryerjes së veprës penale dhe duke injoruar rrethanat lehtësuese. Kjo sipas parashtruesit të kërkesës ka rezultuar në një vendimmarrje të paarsyetuar nga gjykatat e rregullta lidhur me faktet kryesore e cila ka determinuar një dënim më të disfavorshëm për parashtruesin e kërkesës.
71. Këto kategori pretendimesh, e që në thelb ndërlidhen me mungesën e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, dhe në vijim, në mënyrë që të konstatojë nëse Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së përkritazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor, Gjykata fillimisht do të rikujtojë parimet e përgjithshme të GjEDNj-së dhe të Gjykatës në këtë kontekst, dhe më pas do të aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

*Parimet e përgjithshme përkritazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor*

72. Përkritazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë](#), Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998;



Garcia Ruiz kundër Spanjës, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; Hirvisaari kundër Finlandës, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; Suominen kundër Finlandës, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; Buzescu kundër Rumanisë, Aktgjykim i 24 majit 2005; Pronina kundër Ukrainës, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe Tatishvili kundër Rusisë, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por pa u kufizuar në KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019; KI35/18, me parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019 dhe KI227/19, me parashtrues *N.T. “Spahia Petrol”*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2020.

73. Garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës, dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë obligimin e gjykatave që të arsyetojnë mjaftueshëm vendimet e tyre vërtetë (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI143/21, me parashtrues *Hidroenergji Sh.p.k.*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 113; shih rastin e GjEDNJ-së H. kundër Belgjikës, kërkesa 8950/80, paragrafi 53, të 30 nëntorit 1987). Vendimi i arsyetuar u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
74. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin mbi të cilin ato bazohen në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 IF Skadeforsikring, të cituar më lart, paragrafi 48 dhe KI188/21, me parashtrues *Zenel dhe Isuf Pllashniku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 korrikut 2022, paragrafi 78). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin Moreira Ferreira kundër Portugalisë (Nr.2), nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).
75. Gjykata ka theksuar se neni 31 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e Gjykatës KI143/22, me parashtrues *Hidroenergji Sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 120; dhe KI208/23, me parashtrues *Telekomi i Kosovës Sh. A.*, i cituar më lart, paragrafi 53, dhe shih po ashtu rastet e GjEDNJ-së, Burg dhe të tjerët kundër Francës, nr. 34763/02, Vendim i 28 janarit 2003; Gorou kundër Greqisë (nr. 2), nr. 12686/03, Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
76. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo vlerëson se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e



vërtetuar, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. [KI72/12](#), *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. [KI135/14](#), *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe [KI96/16](#) *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017 shih rastet e Gjykatës [KI87/18](#) parashtrues *IF Skadeforsikring*, cituar më lart, paragrafi 44; [KI138/19](#) parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, cituar më lart, paragrafi 138).

77. Gjykata rithekson se nuk është detyra e saj që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta, që janë në pozitë më të mirë për t'i vlerësuar provat në dispozicionin e tyre, t'i konstatojnë faktet dhe interpretojnë të drejtën vendore (shih, për shembull, rastin e GjEDNJ-së, [Khamidov kundër Ruisisë](#), nr. 72118/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2007, paragrafi 170). Gjykata thekson se kur bëhet fjalë për konstatimin e fakteve dhe interpretimin e ligjit, është e “*ndjeshme*” për natyrën subsidiare të rolit të saj dhe se duhet të jetë e kujdesshme në marrjen e rolit të gjykatës së faktit, veçse kur një gjë e tillë është bërë e pashmangshme nga rrethanat e rastit (shih, për shembull, rastin e GjEDNJ-së, [Bărbulescu kundër Rumanisë](#), nr. 61496/08, Aktgjykim i 2017, paragrafi 129).
78. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese rasti nr. [KI33/16](#), parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91). Pavarësisht nga hapësira e vlerësimit të gjykatave të rregullta, vendimi përfundimtar lidhur me respektim të kriterëve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së ngelet tek Gjykata Kushtetuese (shih dispozitat e neneve 4, paragrafi 6 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 112 paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës; dhe po ashtu, shih, *mutatis mutandis*, rastin e GjEDNJ-së, [Konstantin Markin kundër Ruisisë](#), nr. 30078/06, Aktgjykim i 22 marsit 2012, paragrafi 126).
79. Në aplikimin e parimeve të përgjithshme e të shtjelluara më lart, në rrethanat e rastit konkret, dhe në mënyrë që të vlerësohet nëse Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në përputhje me garancitë kushtetuese për një vendim të arsyetuar gjyqësor, Gjykata rikujton që në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar të saj, Gjykata Supreme në procedurën e rigjyimit kishte konfirmuar Aktgjykimin [PKr. nr. 141/2022] e Gjykatës Themelore të 22 nëntorit 2022, i cili ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit, ku parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes sipas nenit 172; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1, si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafët 1 dhe 3 të Kodit Penal, dhe rrjedhimisht ishte shqiptuar dënimi me burgim në total prej 20 vitesh ndaj parashtruesit të kërkesës.
80. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston vendimmarrjen e gjykatave të rregullta duke pretenduar mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, duke theksuar, ndër të tjera dhe siç është sqaruar më lart, se Aktgjykimi i kontestuar në lidhje me aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Themelore kanë dështuar që të ofrojnë arsyetim të mjaftueshëm lidhur me vlerësimin e fakteve relevante të rastit që kanë çuar në vendimmarrjen konkrete nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë vlerësimin dhe aplikimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në disfavor të parashtruesit të kërkesës duke rezultuar në një dënim të rëndë për parashtruesin, pa një analizë dhe arsyetim të mjaftueshëm të rrethanave juridike dhe faktike gjatë vendimmarrjes në rastin konkret.

81. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përkitazi me këtë pretendim thekson se Aktgjykimi i Apelit dhe ai i Gjykatës Supreme nuk përmbajnë arsye bindëse se përse pretendimet e tij, të ngritura në ankesë dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ishin të paqëndrueshme dhe të pabazuara në lidhje me vendimin për dënimin. Në këtë kuptim parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat respektive thjeshtë kanë pranuar gjetjet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me shqiptimin e sanksionit penal (dënimit) pa ofruar arsyetim të mjaftueshëm gjyqësor lidhur me vendimmarrjen e tyre.
82. Prandaj, duke pasur parasysh pretendimin kryesor ankimor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se duhet të analizohet nëse gjykatat e rregullta, kanë dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme mbi të cilat i kanë mbështetur vendimet e tyre, lidhur me shqiptimin e sanksionit penal.
83. Gjykata, në vijim, rikujton arsyetimin e Gjykatës Themelore përmes Aktgjykimit [PKr. nr. 141/2022] të 22 nëntorit 2022, ku përkitazi me faktet vendimtare, rrethanat lehtësuese e ato rënduese, që çuan në vendimmarrjen e saj, ishin arsyetuar si në vijim:

*“Më rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit për të akuzuarin Vllaznim Hamdija, Gjykata, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së mbi Rregullat e Përgjithshme për Matjen e Dënimit dhe Zbutjen dhe Ashpërsimin e Dënimit, vlerësoi dhe analizoi të gjitha rrethanat për individualizimin e dënimit kryesit të veprave penale. Me këtë rast, si rrethanë rënduese për të akuzuarin sa i përket veprës penale të vrasjes, gjendet se ai ka manifestuar shkallë të lartë të dashjes, ngase derisa i ndjeri L.S., pas mosmarrëveshjes lidhur me aksidentin, ishte drejtuar drejt kamionit të tij dhe ishte ulur në ulësen e vozitësit, i akuzuari i ka shkuar pas tij dhe ka shkrepur nga revolja, duke e qëlluar në pjesën e kokës. Po ashtu se i akuzuari ka manifestuar shkallë të lartë për të kryer veprën penale, flet edhe fakti se i njëjti më pas revolen ia kishte drejtuar edhe djalit të ndjerit, tani të dëmtuarit B.S., e cili më pas kishte vrapuar në drejtim të rrugës, e që aty kishte takuar patrullën policore. Vrasjen i akuzuari e kishte kryer në prezencë të djalit të të ndjerit, tani të dëmtuarit B.S., e tek i cili kishte shkaktuar një shqetësim të madh. Në kohën e kryerjes së veprës penale, i akuzuari ka qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës, e që mision ka pasur mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarit, e që në kundërtën i njëjti me armë zyrtare e ka privuar nga jeta tani të dëmtuarin duke qenë në gjendje të përgjegjshme. Me rastin e kryerjes së veprës penale është shkaktuar dëm i pariparueshëm, përkatësisht vdekja e të ndjerit”.*

*Sa i përket veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 367, par. 1 dhe 3, të KPRK-së, si rrethanë rënduese është marrë fakti se i akuzuari në cilësinë e personit zyrtar-pjesëtar i Policisë së Kosovës, e ka ditur që mbajtja e armëve pa leje është e ndaluar dhe e sanksionuar me ligj si vepër penale, por edhe përkundër kësaj i njëjti ... duke shtënë me revole në prezencën e shumë personave, e që ka mundur të jenë pasojat edhe më të mëdha”.*

84. Gjykata tutje i referohet edhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 731/2022] të 26 janarit 2023 të Gjykatës së Apelit, e cila kishte arsyetuar si në vijim: *“Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesave të ushtruara, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike, është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila rezulton nga pranimi i fajësisë,*

nga ana e të akuzuarit, si dhe provave tjera sipas shkresave të lëndës, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimin dhe llojin e lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPK-së, ashtu që ka pasur parasysh si rrethana lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, se është familjar, i martuar, se ka shpreh keqardhje për veprën e kryer penale, dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me Ligjin, se do të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtave, duke apostrofuuar dashjen si formë të kryerjes së veprës penale, andaj ka shqiptuar dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit”.

85. Gjithashtu, Gjykata vëren se të njëjtat pretendime ishin ngritur edhe në Gjykatën Supreme, e cila përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 135/2023] të 10 majit 2023, kishte sqaruar si në vijim:

[...]

Në këtë drejtim, si rrethanë rënduese është vlerësuar "shkalla e lartë e dashjes", pasi që i ndjeri Lulzim Spahiu, pas mosmarrëveshjes lidhur me aksidentin, ishte drejtuar drejt kamionit të tij dhe ishte ulur në ulësen e vozitësit, kurse i dënuari i ka shkuar mbrapa dhe ka shkrepur nga revolja në pjesën e kokës. **Po ashtu, i dënuari kishte manifestuar shkallë të lartë për të kryer veprën penale, pasi që i njëjti ja kishte drejtuar revolen edhe djalit të të ndjerit, tani të dëmtuarit Blend Spahiu, i cili më pas kishte vrapuar në drejtim të rrugës, e që aty kishte takuar patrullën policore.** Në këtë mënyrë, i dënuari e kishte kryer vrasjen në prezencë të djalit të të ndjerit Blen Spahiu, e tek i cili kishte shkaktuar një shqetësim të madh.

Përveç këtyre rrethanave, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye të mjaftueshme se pse është trajtuar si rrethanë rënduese fakti se **i dënuari Vllaznim Hamdija në kohën e kryerjes së veprës penale kishte qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës, kurse vrasjen e kishte kryer me armën zyrtare, duke shkaktuar një dëm të pariparueshëm, përkatësisht vdekjen e të ndjerit.**

Në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Kosovës çmon se me drejtë është vepruar kur është marrë për bazë si rrethanë rënduese fakti se i dënuari Vllaznim Hamdija në **kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës,** kurse vrasjen e kishte kryer me armën zyrtare, pasi që misioni i tij si zyrtar policor do të duhej të ishte pikërisht mbrojtja e jetës dhe pronës së qytetarëve, kurse i njëjti pronës së qytetarëve, kurse i njëjti përkundër kësaj, me armë zyrtare e privon nga jeta të ndjerin Lulzim Spahiu, kurse në anën tjetër, po ashtu, duke qenë person zyrtar kishte poseduar pa autorizim edhe disa armë tjera, siç është cekur më lart. Gjithashtu, i njëjti e kishte përdorur armën në restorantin "EMA" në fshatin Malishevë, komuna e Gjilanit ...”.

86. Bazuar në arsyetimet e lartcekura të gjykatave të rregullta, Gjykata vëren se të njëjtat, fillimisht pasi kishin shqyrtuar të gjitha faktet dhe rrethanat në lidhje me rastin konkret, dhe kishin vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese në rastin konkret, duke marrë parasysh si faktor kryesor **(i)** pranimin e fajësisë, statusin civil, kontekstin personal dhe moral të parashtruesit të kërkesës, të vlerësuar si rrethana lehtësuese; si dhe **(ii)** mënyrën, rrethanat konkrete, sjelljen, intensitetin, pasojat, dashjen e kryerjes së veprës penale, si dhe faktin që parashtruesi ishte në funksion zyrtar dhe vepra u krye me armë zyrtare, të cilat u konsideruan si rrethana rënduese.

87. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ngrit pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, duke kontestuar vlerësimin e gjendjes faktike nga gjykatat e rregullta si të paplotë. Në lidhje me këtë, parashtruesi argumenton se disa fakte janë mbetur pa u përfshirë/shqyrtuar në mënyrë të plotë në rastin e tij, duke mos u trajtuar asnjëherë çështja e afektit nën të cilin u krye vepra penale, duke evidentuar mungesën e verifikimit të faktorëve tjerë relevantë dhe moszbatimi i Udhëzuesit për Politika Ndëshkimore. Në këtë aspekt, parashtruesi nënvizon se disa nga faktet e rastit janë përzgjedhur nga gjykatat për t' i konsideruar si rrethana rënduese, si dëmi i pariparueshëm, pozicioni zyrtar i tij dhe rrethana të tjera konkrete gjatë kryerjes së veprës penale, dhe në anën tjetër pretendon se janë anashkaluar disa fakte të tjera që mund të konsideroheshin si rrethana lehtësuese në favor të parashtruesit të kërkesës.
88. Në këtë aspekt, Gjykata dëshiron të vë në pah arsyetimin e Gjykatës Supreme e cila kishte sqaruar se *"është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë që të merr parasysh si rrethana rënduese, edhe rrethanat tjera të rastit përkatës pavarësisht se një rrethanë e tillë nuk është parashikuar në mënyrë decizive dhe shprehimore në nenin 69, paragrafi 3 dhe nenin 70, paragrafi 2 të KPRK-së, kuptohet nëse një "rrethanë e tillë" vlerësohet se ndikon në ashpërsimin e dënimit, gjithnjë duke pasur parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit për veprën penale përkatëse, qëllimin e dënimit, si dhe parimet tjera të përcaktuara me KPRK [...]".*
89. Gjithashtu, Gjykata vëren se neni 70 [Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit], paragrafi 2 të Kodit Penal përcakton se *"Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese [...]".*
90. Në kontekstin e pretendimeve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, ku theksohet se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh faktet që ligjërisht nuk klasifikohen si rrethanë rënduese, siç është *"dëmi i pariparueshëm"*, Gjykata vë në dukje se Gjykata Supreme e ka sqaruar këtë çështje. Duke u bazuar në konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se *"me kryerjen e veprës penale është shkaktuar një dëm i pariparueshëm, vdekja e personit të ndjerë"*, Gjykata Supreme ka sqaruar këtë çështje duke argumentuar se konstatimi i dëmit të pariparueshëm, në këtë rast vdekja e një personi, ishte faktor i rëndësishëm për vlerësimin e rrethanave të një vepre penale, siç është vrasja. Ky argument bazohet në faktin se gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar këtë element në kontekstin e rrethanave të tjera të rëndësishme dhe ngjarjes në tërësi, duke e vlerësuar atë si pjesë integrale të ngjarjes dhe jo si një rrethanë autonome e veprës penale të vrasjes.
91. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta në mënyrë specifike i janë përgjigjur pretendimit të parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtësit të tij, në lidhje me vendimin për dënim, përkatësisht lartësinë e dënimit, duke vlerësuar se në rastin e tij u morën parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të rastit dhe mbi bazën e individualizimit të dënimit parashtruesit të kërkesës i është shqiptuar dënimi brenda kufijve të paparapare me veprën penale.
92. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta, përgjatë vendimmarrjes së tyre me qëllim të vërtetimit të bazueshmërisë së pretendimeve, i zbatuan të gjitha veprimet dhe i administruan provat. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme, përfshirë Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit, kanë prezantuar argumente bindëse dhe të mjaftueshme përmes vendimeve të tyre, duke analizuar me thellësi bazën ligjore që ka shërbyer si mbështetje për vendimmarrjen e tyre në lidhje me rastin. Përshkrimi i detajuar dhe i qartë i arsyetimit të Gjykatës Supreme përfshinë një analizë logjike të



rrethanave specifike dhe cilët faktorë janë vlerësuar si rrethana lehtësuese dhe renduese për parashtruesin e kërkesës.

93. Gjykata, dëshiron të rikujtojë gjithashtu, se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GjEDNj-se, [Van de Hurk kundër Holandës](#), Aktgjykimi i 19 prillit 1994; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26).
94. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se "drejtësia" e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi "*substanciale*", por drejtësi "*procedurale*". Në rrafshin praktik, koncepti i "*drejtësisë procedurale*" nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-se [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: [KI128/19](#), cituar më lart, paragrafi 58; dhe [KI22/19](#), parashtrues i kërkesës [Sabit Ilazi](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
95. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqet pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare në mënyrë efektive; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; dhe se arsyt faktike dhe juridike për vendimin e kontestuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i 21 janarit 1999, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin [KI22/19](#), parashtrues [Sabit Ilazi](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; si dhe rasti [KI128/18](#), i cituar më lart, paragrafi 58).
96. Gjykata, konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta, vendimtarja e të cilave është në pajtueshmëri të plotë me standardet e kërkuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe neni 6.1 të KEDNj-së. Parashtruesi i kërkesës edhe më tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tij, megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNj-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
97. Gjykata ka thënë gjithmonë se në përgjithësi nuk është detyra e saj të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit që pretendohet se janë kryer nga një gjykatë e rregullt, përveç nëse dhe për aq sa këto gabime janë të dukshme dhe kanë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (shih, në lidhje me doktrinën e "*shkallës së katërt*", rastin e GjEDNj-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit



1999, paragrafi 28; [Perez kundër Francës , kërkesa nr. 47287/99](#), Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 82). Duke qenë kështu, Gjykata nuk mund të vërë në dyshim gjetjet e gjykatave të rregullta mbi gabimet e supozuara të ligjit, përveç nëse ato janë “*arbitrare ose haptazi të paarsyeshme*” (shih rastin e GjEDNj-së, [Scordino kundër Italisë, kërkesa nr. 36813/97](#), Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafi 191, dhe [Nait-Liman kundër Zvicrës kërkesa nr. 51357/07](#), Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 116). Detyra e Gjykatës në lidhje me nenin 31 është të shqyrtojë kërkesat që pretendojnë se gjykatat e rregullta kanë dështuar të respektojnë “*garancitë specifike procedurale*” të përcaktuara në atë nen (shih rastin e GjEDNj-së, [De Tommaso kundër Italisë, kërkesa nr. 43395/09](#), Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 171). Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë arbitrariteti që në vetvete do të ngrinte çështje në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, nuk i takon Gjykatës të gjykojë nëse gjykatat e rregullta kanë zbatuar drejt një dispozitë ligjore të një ligji të caktuar.

98. Duke vepruar kështu, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GjEDNj-së.
99. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës bie në kategorinë e dytë (ii) pretendime me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, andaj Gjykata, si të tilla, në baza kushtetuese i deklaroi qartazi të pabazuara dhe rrjedhimisht të papranueshme, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

***Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 33.3 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNj-së.***

100. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se garancionet e mishëruar nga neni 33.3 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], në lidhje me nenin 7 [Nuk ka dënim pa ligj] të KEDNj-së, janë shkelur nga ana e gjykatave të rregullta me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj tij me arsyetimin se dënimi ndaj tij është shqiptuar pa u verifikuar faktet vendimtare të rastit dhe pa trajtuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme, duke vënë në dyshim arsyetimet e gjykatave të rregullta lidhur me konstatimin e “*shkallës së lartë të dashjes*” së tij gjatë kryerjes së veprës penale si dhe moszbatimin e Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore gjatë shqiptimit të dënimit.
101. Në lidhje me këtë, parashtruesi pohon se nëse rrethanat do të trajtoheshin në mënyrë të drejtë dhe do të zbatoheshin politikën për ndëshkimin nga gjykatat e rregullta, dënimi do të ishte më i lehtë dhe në përputhje/proporcion me natyrën e veprës dhe rrethanat e kryerjes së saj.
102. Gjykata fillimisht thekson se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës, se në rastin e tij gjykatat e rregullta duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese përkitazi me matjen e dënimit, kanë bërë vlerësim të gabuar të rrethanave në dëm të tij, Gjykata vëren se ky pretendim tashmë është adresuar si më sipër nga Gjykata në kuadër të së drejtës për vendim të arsyetuar, dhe nuk e konsideron të nevojshme ta përsërisë të njëjtin vlerësim (shih paragrafët 86-92 të këtij aktvendimi).
103. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës avancoi pretendimin e tij për shkelje të nenit 33.3 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNj-së, duke theksuar se ashpërsia e dënimit të shqiptuar nga gjykatat rregullta është në disproporcion me veprën penale të kryer nga ai.

104. Gjykata në vazhdim rikujton përmbajtjen e paragrafit 3, të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 33

[Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale] i Kushtetutës

[...]

3. *Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.*

[...]

105. Gjithashtu, Gjykata do t' i referohet edhe përmbajtjes së nenit 7.1 [Nuk ka dënim pa ligj] të KEDNJ-së, i cili thekson:

1. *“Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. **Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale**”.*

[...]

106. Gjykata fillimisht thekson se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës dhe nenit 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, Gjykata rikujton që neni 7 i KEDNJ-së duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtje efektive nga ndjekja, dënimi ose ndëshkimi arbitrar. Gjykata gjithashtu përkujton që neni 7. 1 i KEDNJ-së nuk garanton vetëm parimin e ndalimit të aplikimit retroaktiv të ligjeve më të rrepta penale, por gjithashtu edhe, në mënyrë implicite, parimin e aplikimit të ligjit më të butë penal (shih rastin e Gjykatës [KI37/18](#), parashtrues *Naser Avdyli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 majit 2018 si dhe rastin e GjEDNJ-së, [Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03](#), Aktgjykimi i 17 shtatorit 2009, paragrafi 109).
107. Gjykata thekson se është në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, pjesë thelbësore e të cilit përbën neni 33 i Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, të pritet që gjykatat e rregullta të zbatojnë për çdo akt të dënueshëm dënimin që ligjvënësi e konsideron proporcional (shih rastin e GjEDNJ-së, [Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr.10249/03](#), cituar më lart, paragrafi 108).
108. Gjykata thekson se neni 33 i Kushtetutës në lidhje me nenin 7, paragrafi 1 të KEDNJ-së shkon përtej ndalimit të zbatimit retrospektiv të ligjit penal në dëm të të akuzuarit. Ai gjithashtu parashtron, në përgjithësi, parimin se vetëm ligji mund të përcaktojë një krim dhe të parashikojë një dënim (*nullum crimen, nulla poena sine lege*). (Shih rastin e GjEDNJ-së, [Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr.10249/03](#), cituar më lart, paragrafi 93).
109. Gjykata nënvizon se neni 7 i KEDNJ-së, në rast të mungesës së një ‘fajësimi’ formal’, përjashton caktimin e një sanksioni penal për një individ për sa kohë nuk është konstatuar dhe deklaruar paraprakisht përgjegjësia penale personale. Përndryshe do të shkelej parimi i prezumimit të pafajësisë i garantuar edhe nga vet neni 6, paragrafi 2 i KEDNJ-së. (Shih rastin e GjEDNJ-së, [G.I.E.M. S.r.l. dhe të Tjerë kundër Italisë kërkesa nr. 1828/06, 34163/07 dhe 19029/11](#), Aktgjykim i 28 qershorit 2018).



110. Gjykata thekson se formulimi i nenit 7, paragrafi 1, fjalia e dytë, tregon se pikënisja në çdo vlerësim të ekzistencës së një “dënimi” është nëse masa në fjalë është shqiptuar pas një vendimi se një person është fajtor për një vepër penale. Megjithatë, faktorë të tjerë mund të merren parasysh si të rëndësishëm në lidhje me këtë, përkatësisht natyra dhe qëllimi i masës në fjalë; karakterizimin e tij sipas ligjit vendor; procedurat e përfshira në marrjen dhe zbatimin e masës; dhe ashpërsia e tij (shih rastet e GjEDNJ-së, [Welch kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 17440/90](#), Aktgjykim i 9 shkurtit 1995, paragrafi 28; [Jamil kundër Francës, kërkesa nr. 15917/89](#), Aktgjykim i 25 majit 1995, paragrafi 31; [Kafkaris kundër Qipros, kërkesa nr. 21906/04](#), paragrafi 142; [M. kundër Gjermanisë, nr. 19359/04](#), paragrafi 120, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2009; [Del Río Prada kundër Spanjës, kërkesa nr. 42750/09](#), paragrafi 82, Aktgjykim 21 tetorit 2013 dhe [Société Oxygène Plus kundër Francës, nr. 76959/11](#), Aktgjykim 6 dhjetorit 2011, paragrafi 47).
111. Nga kjo rezulton se veprat penale dhe dënimet përkatëse duhet të përcaktohen qartë me ligj. Kjo kërkesë plotësohet kur individit mund të dijë nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimit të saj nga gjykatat, çfarë veprimesh dhe mosveprimesh do ta bëjnë atë penalisht përgjegjës (shih rastin e GJEDNJ-së, [Kokkinakis kundër Greqisë](#), Aktgjykimi i 25 majit 1993, paragrafi 52).
112. Prandaj, Gjykata duhet të verifikojë se në kohën kur një person i akuzuar ka kryer aktin që ka çuar në ndjekjen dhe dënimin e tij, ka pasur një dispozitë ligjore që e bën atë akt të dënueshëm dhe se dënimi i shqiptuar nuk i ka kaluar kufijtë e përcaktuar nga kjo dispozitë ligjore. (Shih rastin e GJEDNJ-së [Coëme dhe të tjerët kundër Belgjikës](#), Aktgjykim i 22 qershorit 2022, paragrafi 145).
113. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se “*ashpërsia e dënimit të shqiptuar është në disproporcion me veprën penale*” për të cilën ai është shpallur fajtor dhe dënuar, Gjykata vlerëson se ky pretendim në të vërtetë ngrenë çështje kushtetuese nga paragrafi 3 i nenit 33 të Kushtetutës. Për të arritur në një vlerësim objektiv, Gjykata thekson se dispozita kushtetuese në fjalë, kërkon referim në dispozitën përkatëse të Kodit Penal, me të cilën përcaktohen kufijtë minimal dhe maksimal të sanksionit penal për veprat penale përkatëse.
114. Gjykata rikujton se Gjykata Themelore në procedurën e rigjyimit, përmes Aktgjykimit [PKr. nr. 141/2022] duke u bazuar në dispozitat e Kodit Penal kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të vrasjes sipas nenit 172 duke e dënuar me 19 (nëntëmbëdhjetë) vite burgim; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1, duke e dënuar me 1 (një) vit burgim; si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafët 1 dhe 3 të Kodit Penal duke e dënuar me 2 (dy) vite burgim.
115. Gjykata vëren se Gjykata Themelore me zbatimin e dispozitave për dënimin unik, parashtruesit i ka shqiptuar dënim me burgim në total prej 20 (njëzet) vitesh, duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e armëve dhe fishekëve të gjetur në pronësi të të akuzuarit.
116. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor dhe është dënuar nga gjykata e shkallës së parë për kryerjen e veprës penale nga neni 172 i Kodit Penal, i cili përcakton:

## Vrasja

*“Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim”.*

117. Gjykata vëren se neni 172 i Kodit Penal përcakton një lartësinë minimale të dënimit për veprën e vrasjes, duke përcaktuar se personi që e privon një person tjetër nga jeta dënohet *“me jo më pak se pesë (5) vjet burgim”*, nuk specifikon një limit maksimal të dënimit. Pra, neni 172 përcakton pesëvjeçarin si minimum për dënimin e vrasjes. Kjo do të thotë që, nëse dikush dënohet për vrasje, dënimi minimal që mund të marrë është pesë vjet burg. Megjithatë, kjo dispozitë nuk parandalon një dënim më të rëndë nëse rrethanat e rastit e kërkojnë.
118. Në vijim, Gjykata gjithashtu do të referohet edhe dispozitave tjera ligjore të Kodit Penal lidhur me pretendimet e parashtruesit për dënim disproporcional ndaj tij.
119. Gjykata përsëri vë në dukje se parashtruesi i kërkesës gjithashtu ishte dënuar për mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, paragrafi 1, duke e dënuar me 1 (një) vit burgim; si dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 367, paragrafët 1 dhe 3, të Kodit Penal duke e dënuar me 2 (dy) vite burgim.
120. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se neni 366 i Kodit Penal lidhur me shqiptimin e dënimit përcakton se *“1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”.*
121. Ndërsa, neni 367 i Kodit Penal përkritazi me shqiptimin e dënimit përcakton se *“Kushdo që përdor armën apo materiale plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”.*
122. Gjykata vëren që përmbajtja e dispozitave të mësipërme të Kodit Penal parashohin format e sanksionimit, duke përfshirë edhe lartësinë maksimale të dënimit për veprat penale përkatëse. Në këtë rast, dënimet e dhëna kundër parashtruesit të kërkesës janë brenda kufijve ligjorë.
123. Gjykata gjithashtu do të theksojë se, përveç dënimeve të shqiptuara veç e veç kundër parashtruesit të kërkesës, në rastin e tij janë zbatuar dispozitat për dënimin unik me burgim, duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim, për një total prej 20 (njëzet) vitesh.
124. Gjykata përmes një vëzhgimi të përgjithshëm thekson se në rastin e parashtruesit të kërkesës ishte konstatuar përgjegjësia penale ndaj tij dhe rrjedhimisht ishte shpallur fajtor. Për pasojë, sanksionet penale janë shqiptuar ndaj tij në përputhje me legjislacionin zbatues nga ana e gjykatave të rregullta.
125. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se ashpërsia e dënimit në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk duket të jetë në disproporcion me veprat penale të ngarkuara.
126. Andaj, nga shtjellimet e mësipërme, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se ashpërsia e dënimit është në disproporcion me veprën penale, i takojnë kategorisë së dytë (ii) që karakterizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* dhe si të tilla, të njëjtat në baza kushtetuese, Gjykata i deklaron qartazi të pabazuara, dhe rrjedhimisht të papranueshme, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

## Përfundim

127. Si përmbledhje, Gjykata lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, për të drejtën për vendim të arsyetuar, dhe pretendimi për shkelje të nenit 33.3 të Kushtetutës, Gjykata i kualifikon si pretendime të kategorisë së dytë (ii) që karakterizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe si të tilla, të njëjtat në baza kushtetuese janë qartazi të pabazuara.
128. Andaj, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në tërësinë e saj, duhet të deklarohet qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme, siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2024, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

